



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odaljenje za Opštë Upravu

-III- Nr. i prot. ASHAD Mö 16.04.21  
Br. prot. Dt. 16.04.20  
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opštine Orahovac / Municipal Rahovec

**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim**  
Odelenje za Zastitu i Spasavanje  
Department for Protection and Rescue

## RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS JANAR-MARS 2021

---

## **Gjatë këtij 3 mujori ne si drejtori kemi pasur aktivitete si mëposhtë:**

- ❖ Gjatë 3 majorit të parë të vitit si drejtor kam qenë i angazhuar në menaxhim të kontratës për mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga komuna kemi qenë tërë kohën në terren, në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuara ndonjë vështirësi në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorve.
- ❖ Si drejtor poashtu kam qenë i angazhuar në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriqimit publik, gjatë këtij 3 mujori kemi arritë të intervenojmë në çdo vendbanim të komunës ku ka pasur probleme me ndriqim publik.
- ❖ Në njësinë e zjarrfiksave në këtë 3 major kemi pasur 99 raste që kemi dal në intervenim, pothuajse të gjitha rastet kanë qenë intervenime të lehta, vetëm një numër i vogël i tyre ishin intervenime të natyrës pak më të rëndë por që fatmirësisht nuk ka pasur viktima por vetëm ka pasur dëme materiale, rastet të natyrës pak më të rënda kanë qenë vërshimet.
- ❖ Angazhim të rregullt në KKSB( Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi).
- ❖ Me datë 10-11 janar komuna jonë është përfshirë nga rreshje të mëdha të shiut ku edhe kemi pasur vërshime dhe përmbytje të mëdha në pjesën më të madhe të territorit të komunës sonë, i kemi mobilizuar të gjitha njësitet emergjente të komunës për të ju dal në ndihmë banorëve të prekur nga vërshimet, poashtu kemi pasur edhe evakuime të disa familjeve nga shtëpitë e tyre për shkak të rrezikut të madh nga vërshimet.
- ❖ Pjesëmarrës në takimet e shtabit emergjent komunal për menaxhimin e situatës me virusin COVID-19.
- ❖ Janë inspektuar lumenjtë, përockat dhe kanalet e hapura dhe pas inqizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse për trajtim të kanaleve të bllokuara, pastrim të përockave etj.

- ❖ Është bërë regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste Emergjente dhe poashtu janë bërë të gjitha përgaditjet për sezoni e nxehtë të verës.
- ❖ Është bërë inspektimi i rregullt i objekteve publike dhe inspektimi i objekteve ekonomike dhe private në lidhje me paisjen e tyre me mjete mbrojtëse kundër zjarrit.

15.04.2021

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Rahovec

Hasan Përboqi

